

Data 15.11.2020

LËNDA: FTESË PËR OFERTË PËR BLERJE PRODUKTESH DHE SHËRBIMESH

Të nderuar,

Nëpërmjet kësaj letre, ju ftojme të paraqesni ofertën tuaj lidhur me blerjen e produkteve dhe shërbimeve për prishje e pllakave ekzistuese, nënshtresës dhe katramasë dhe transport materialeve në ambientet e zyrës së QShPZh që do të zhvillohet nga organizata Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh).

Informacion i përgjithshëm rreth QShPZh

QShPZh-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), për të siguruar funksionalitet e verandës në mënyrë që gjatë rreshjeve të shiut mos të deportojë lageshtia në thellësi të soletës dhe të pikoje në ambientin tregtar në katin +2, parashikohet të bëhen ndërhyrje për prishje e pllakave ekzistuese, nënshtresës dhe katramasë dhe transport materialeve në ambientet e zyrës së QShPZh.

TERMA REFERENCE

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Synimi i përgjithshëm është blerja e produkteve dhe shërbimeve për prishje e pllakave ekzistuese, nënshtresës dhe katramasë dhe transport materialeve në ambientet e zyrës së QShPZh për të siguruar funksionalitet e verandës në mënyrë që gjatë rreshjeve të shiut mos të deportojë lageshtia në thellësi të soletës dhe të pikoje në ambientin tregtar në katin +2.



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Objekti

- Blerja e produkteve dhe shërbimeve të kërkuara janë sipas listës në vijim:

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia e parashikuar	Cmimi /njësi (ALL)	Vlera (ALL)
1	Prishje e pllakave ekzistuese, nënshtresës dhe katramasë dhe transport materiale	m3	14.68	5,000	73,400

2. Data dhe vendi

Me kërkesë të organizatës, ofertat e produkteve dhe shërbimeve do të dorëzohen në Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë. Tel: +042251475

3. Profili i kërkuar i aplikantit

- Subjekt tregtari i regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi.

4. Përzgjedhja dhe Tarifat

Operatori ekonomik i cili do të përzgjidhet për ofrimin e shërbimit të lartë përmendur, do ti kryhet pagesa pas dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve dhe faturës përkatëse në llogarinë bankare të subjektit.

Aplikimi

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë).

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- NIPT, Ekstrakt historik
- Oferta Financiare përfshirë TVSH për shërbimin që kërkohet.

*Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin(QSHPZH)
Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Shqipëri.*



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për ofertën më të ulët financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

Për cdo pyetje, ju lutem mos ngurroni ti adresoni në adresën e email: info@acpd.org.al